



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Seancë plenare e Kuvendit

P- 011

Prishtinë, më 14 mars 2008, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
MË 14 MARS 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 94 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se, në bazë të rregullave 6. 2 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur me 26, 27, 28 e 29 shkurt dhe 3 mars 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2007,
4. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave,
5. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë për zgjedhjen e drejtorit të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale e Media dhe i Komisionit Parlamentar ad hoc lidhur me emërimin e dy anëtarëve në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 26, 27, 28 e 29 shkurt dhe 3 mars 2008

Procesverbalet e seancës plenare të 26, 27, 28 e 29 shkurt dhe 3 mars 2008 u miratuan pa vërejtje.

Deputetja **Suzan Novobrdaliu** pati vërejtje në transkript, e cila është përmirësuar.

2. Koha për pyetje parlamentare

1. Deputeti **Nait Hasani** i parashtroi pyetje ministres së Drejtësisë lidhur me gjendjen e disa grupeve të gjykuara - pjesëtarë të UÇK-së, me nga 4 e 5 vjet burg, të cilët tashmë sa vite janë pa gjykime të plotfuqishme.

Ministrja **Nekibe Kelmendi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Nait Hasani .

2. Deputeti **Riza Smaka (AKR)** i parashtroi dy pyetje ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë. Pyetja e parë kishte të bënte me inicimin e procedurës për hartimin e Projektligjit me të cilin profesorëve të Universitetit u mundësohet të punojnë deri në moshën 70 vjeçare. Pyetja e dytë kishte të bënte me numrin e madh të studentëve që janë regjistruar në Fakultetin Ekonomik dhe në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Kryetari konstatoi se ministri **Enver Hoxhaj** nuk është i pranishëm në seancë, prandaj sipas rregullave pyetja do të publikohet në Buletin e Kuvendit.

3. Deputeti **Zafir Berisha (PDK)** i parashtroi pyetje ministres së Energjisë dhe të Minierave lidhur me gjendjen e rëndë energjetike në Kosovë, si dhe nëse do të vazhdojë plani ABC i reduktimit të energjisë elektrike.

Ministrja **Justina Pula** iu përgjigj pyetjes së deputetit Berisha.

4. Deputeti **Zafir Berisha (PDK)** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me masat që kjo ministri i ka marrë për përmirësimin e kushteve nëpër spitalet e vendit dhe përmirësimin e shërbimeve për pacientët.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Berisha.

5. Deputeti **Driton Tali (AKR)** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me qëndrimin e Qeverisë për projektin e ndërtimit të Termocentralit Kosova C 2100 MGW.

Ministrja **Justina Pula** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

6. Deputetja **Drita Kadriu (PDK)** i parashtroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme lidhur me masat që i ka marrë kjo Ministri për sigurimin e dy pikave doganore të shkatërruara në Leposaviq dhe në Zubin Potok, si dhe për funksionalizimin e Gjykatës në Mitrovicë.

Ministri **Zenun Pajaziti** iu përgjigj pyetjes së deputetes Kadriu

Në vazhdim, seancën e kryesoi **Xhavit Halit**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

7. Deputetja **Gjylnaze Syla (AAK)** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me veprimet që i ka ndërmarrë Qeveria për tu bërë anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtarë dhe anëtare e Bankës Botërore.

Kryeministri **Hashim Thaçi dhe ministri Ahmet Shala**, iu përgjigjën pyetjes së deputetes Syla.

8. Deputetja **Qamile Morina (LDD)** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me veprimet që Qeveria i ka marrë për të krijuar një skemë të sigurimit shëndetësor në Kosovë.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Morina.

3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2007

Kryesuesi i informoi deputetët se në bazë të nenit 82 të Ligjit për Prokurim Publik, Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, Kuvendit ia ka paraqitur Raportin vjetor, i cili me shkrim iu ka shpërndarë deputetëve me kohë.

Kryesuesi ftoi Kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci që të paraqes, rekomandimet e këtij Komisioni.

Gani Koci tha se Komisioni e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, por sipas Ligjit mbi prokurimin publik, neni 82, pika 2, Raportin e këtij organi, para Kuvendit e paraqet kryesuesi i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, ndërsa Komision parlamentar për Buxhet e Financa, pas shqyrtimit do të duhet t'i jepte mendimet dhe qëndrimet lidhur me këtë raport. Prandaj, është dashur që paraprakisht të thirrej kryesuesi i Komisionit që ta paraqesë raportin këtu, dhe pastaj Komisioni dhe grupet parlamentare të shtrojnë pyetje rreth raportit.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** pati vërejtje lidhur me procedurat e paraqitjes së këtij raporti para Kuvendit dhe i propozoi Kuvendit që Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të thirret që të paraqesë raportin para deputetëve, në mënyrë që deputetët të kenë mundësi ti shprehin dilemat dhe vërejtjet e tyre para raportuesit.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së tha se, nëse duhet të përkrahet një propozim i tillë, është gjithashtu rregull që t'i bëhet ftesë zyrtare kryesuesit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për të raportuar para Kuvendit dhe propozoi që shqyrtimi i raportit të shtyhet.

Sabri Hamiti tha se nuk është hera e parë që shqyrtojmë raporte të institucioneve të tilla. Kryesuesi i këtij Komisioni z. Dule është këtu, prandaj grupet parlamentare mund të paraqesin vërejtjet e tyre dhe ai në fund mund të përgjigjet.

Zëvendëskryeministri **Kuçi** shtoi se Qeveria nuk e ka shqyrtuar akoma këtë raport dhe nuk ka ndonjë qëndrim për të, prandaj propozoi që kjo pikë të shtyhet për shqyrtim në një seancë tjetër.

Kryesuesi kërkoi nga grupet parlamentare që të deklarohen lidhur me propozimin për shtyrjen e shqyrtimit të kësaj çështje për një seancë tjetër.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se ky propozim duhet të hedhet në votim e pastaj të vendosë se si do të procedohet.

Eqrem Kryeziu, në emër të Grupit parlamentar LDK-së, tha se e mbështesin votimin për këtë propozim.

Shkumbim Demaliaj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së dhe anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, tha se Komisioni parlamentar e ka shqyrtuar këtë raport në prani të anëtarëve të Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik, ndërsa për procedurat, nëse janë shkelur apo jo, ky Komision nuk ka marrë ndonjë rekomandim nga Qeveria, prandaj mendoj se ky raport duhet të votohet sot.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së tha se ky raport duhet të votohet sot sepse propozimi për ndryshimin e agjendës në këtë fazë do të ishte shkelje e Rregullores së Punës së Kuvendit dhe e praktikës parlamentare.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së tha se si Grup Parlamentar jemi të përgatitur që të procedojmë me rendin e ditës e edhe me këtë çështje.

Zylfi Mergja, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, tha se e mbështet propozimin për shtyrjen e kësaj pike të rendit të ditës për një seancë tjetër.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e zëvendëskryeministri Kuçi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----52,
Kundër----- 28,
Abstenime----- 7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2007, të shtyhet për seancën e radhës.

Në vazhdim, seancën e kryesoi Jakup Krasniqi , Kryetar i Kryesisë së Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale e Media dhe i Komisionit Parlamentar ad hoc lidhur me emërimin e dy anëtarëve në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media ka shqyrtuar Rekomandimin e Komisionit ad – hoc parlamentar nga Legjislatura e dytë, për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media dhe të njëjtin ia ka propozuar Kuvendit për miratim. Ai ftoi, Kryetarin e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, Esat Brajshorin që t’i arsyetojë rekomandimet para deputetëve.

Esat Brajshori tha se Komisioni ad-hoc parlamentar, në mbledhjen e mbajtur më 9 nëntor 2007 ka përzgjedhur 2 nga 4 të propozuarit për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media dhe ka nxjerrë rekomandimin që Kuvendit të Kosovës t’i propozojë emërimin e tyre.

Në vazhdim, ai shtoi se Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, si komision funksional, në mbledhjen e mbajtur më 19. 2. 2008, ka shqyrtuar kërkesën e Komisionit të Pavarur për Media dhe i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit me kërkesën që kjo çështje të procedohet më tutje me qëllim që Këshilli i Pavarur për Media t’i përmbushë objektivat dhe prioritetet e veta të përcaktuara për vitin 2008.

Fehmi Mujota, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe nënkryetar i Komisionit ad-hoc, nga Legjislatura e dytë, tha se sipas Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, ky Komision ad-hoc është takuar më 9 nëntor 2007 dhe ka bërë përzgjedhjen sipas mandatit, ku prej 4 të propozuarve ka përzgjedhur 2 veta. Deputetët nga mandati i kaluar i kanë parë të dhënat për këta kandidat, prandaj ne si Grup Parlamentar e mbështesim këtë propozim.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar LDK-së, deklaroi se i mbështet plotësisht kandidaturat e propozuara nga Komisioni ad-hoc.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se e përkrah propozimin e Komisionit ad-hoc.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se i mbështet plotësisht kandidaturat e propozuara nga Komisioni ad-hoc.

Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, tha se e përkrah këtë propozim.

Kryetari e hodhi në votim propozimin. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----78,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media u zgjedhën :

1. Argjentina Grazhdani dhe
2. Daut Demaku.

5. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave

Kryetari i njoftoi deputetët se në bazë të nenin 12 të Ligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë, Qeveria e Kosovës i është drejtuar Kuvendit me kërkesë për procedim dhe miratim të listës së kandidatëve të propozuar për anëtarë të Komisionit Qendror të Regjistrimit.

Ai ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin **Arsim Bajrami** që ta arsyetojë propozimin.

Ministri **Arsim Bajrami**, duke e arsyetuar nevojën e zgjedhjes së anëtarëve të këtij komisioni tha se Ministria e Shërbimeve Publike, në kuadër të përgatitjeve për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave ka filluar përgatitjet intensive teknike, profesionale, me Entin e Statistikës të Republikës së Kosovës, me donatorë, dhe me Euro-Statin, në mënyrë që të bëhet e mundur që deri në fund të vitit, të fillojë implementimi i procesit të këtij regjistrimi.

Ai, në vazhdim, shtoi se, Qeveria i ka propozuar Kuvendit listën e anëtarëve të Komisionit Qendror i cili Komisioni do të ketë mandatin që t'i ushtrojë të gjitha kompetencat dhe vendimmarrjet politike, të

formojë grupet e ekspertëve, të prodhojë dokumentet e nevojshme, mostrat e nevojshme në mënyrë që regjistrimi i popullsisë të bëhet me kriterë valide dhe sipas standardeve më të larta evropiane.

Kryetari i ftoi grupet parlamentare të deklarohen lidhur me kandidatët e propozuar nga ministri Bajrami.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deklaroi se e mbështet propozimin për anëtarët e këtij Komisioni.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deklaroi se e përkrah propozimin për krijimin e këtij komisioni për shkak se është një proces që ka qenë në pritje, i përgatitur, ka kaluar fazën e regjistrimit testues në disa komuna ka përfshirë edhe testimin e regjistrimit edhe në vende multietnike dhe në komuna me shumicë shqiptare.

Ibrahim Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, tha se e përkrah propozimin e për krijimin e këtij komisioni, por me një plotësim, sepse në Kryesinë e Kuvendit këtij propozimi iu kanë shtuar edhe dy institucione të tjera, që kemi konsideruar të domosdoshme të jenë pjesë e këtij komisioni siq janë Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës dhe Arkivi i Kosovës, prandaj do të duhej që edhe ky propozim ti bashkëngjitet listës.

Kryetari i dha shpjegimet se propozimet duhet të jenë në përputhje me nenin 12 të Ligjit për regjistrimin e popullsisë.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se nuk e mbështet propozimin për anëtarët e këtij Komisioni, për shkak se nuk ka informacione për kandidatët që iu kanë shtuar listës.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se nuk e përkrah propozimin me një përbërje të tillë të Komisionit.

Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar “7+” , tha se e përkrah propozimin për anëtarët e këtij Komisioni.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë propozim dhanë edhe deputetët: **Sabit Rahmani, Mark Krasniqi, Vezira Emrush, Sabri Hamiti, Adem Hajrizi, Gani Geciu, Gjylnaze Sylja, Sadik Idriz, Berim Ramosaj, kryeministri Hashim Thaçi, Riza Smaka, Adem Hajdaraj, Rasim Selmanaj, Zef Morina, Ramandan Avdiu, Naser Rugova, Ibrahim Makolli dhe Donika Kadaj**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari e hodhi në votim propozimin. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----54,
Kundër----- 29,
Abstenime----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

I. Anëtarë të Komisionit Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomisë Familjare dhe të Banesave u zgjodhën :

1. **Rifat Blaka**, nga Ministria e Shërbimeve Publike – kryesues,
2. **Shpend Tërdeva**, nga Zyra e Kryeministrit, anëtar,
3. **Hajdar Korbi**, nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, anëtar,
4. **Shaip Hajrizi**, nga Ministria e Kulturës, Rinisë, Sporteve, dhe Çështjeve Jorezidente anëtar,
5. **Hakile Xhaferi**, nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtare,
6. **Muzafer Caka**, nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, anëtar,
7. **Hysni Thaçi**, nga Enti Statistikor i Kosovës, anëtar,
8. **Rossana Poblet**, zyrtare ndërkombëtare nga Ministria e Shërbimeve Publike, anëtare,
9. **Carlotta Mercante**, zyrtare ndërkombëtare nga Entit Statistikës së Kosovës, anëtare,
10. **Nebojša Azdenković**, nga bashkësia serbe në Kosovë, anëtar dhe
11. **Fikrim Damka**, nga komunitet e tjera jo shumicë në Kosovë, anëtar.

7. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë për zgjedhjen e drejtorit të Autoritetit Qendror Bankar (AQB) të Republikës së Kosovës

Kryetari i informoi deputetët se në pajtim me Nenin 18 (2) (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/47, për Autoritetin Qendror Bankar, Qeveria i ka propozuar Kuvendit zgjedhjen e Drejtorit menaxhues të AQB-së.

Ai ftoi ministrin **Ahmet Shala**, që në emër të e Qeverisë, ta paraqesë propozimin.

Ahmet Shala ministër i Ekonomisë dhe i Financave tha se Qeveria në bazë të neni 9.3 të Kornizës Kushtetuese dhe pas konsultimeve të bëra dhe rekomandimeve të institucioneve financiare ndërkombëtare, siç janë Fondi Ndërkombëtar Monetar, Banka Botërore dhe institucionet e tjera të rëndësishme të pranishëm në Kosovë, i propozon Hashim Rexhepin, drejtor menaxhues të Autoritetit Qendror Bankar.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deklaroi se e përkrah propozimin e paraqitur nga Qeveria.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se do ta mbështesë propozimin e Qeverisë.

Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, tha ky Grup ende nuk ka ndonjë qëndrim të prerë për këtë propozim dhe kërkoi që votimi të jetë i fshehtë.

Rasim Selmanaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se e mbështet propozimin e Qeverisë.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se ky është një proces i rëndësishëm dhe si Grup do të votojnë për propozimin e dhënë.

Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar “7+” , tha se e mbështesin propozimin e Qeverisë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë propozim dhanë edhe deputetët: **Naser Osmani, Driton Tali, Shkumbim Demaliaj, Riza Smaka dhe Rrustem Mustafa**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari e hodhi në votim propozimin. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----49,
Kundër----- 14,
Abstenime----- 13.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori

V E N D I M

Për zgjedhjen e drejtorit menaxhues të Autoritetit Qendror Bankar

1. **Hashim Rexhepi** zgjedhet drejtor menaxhues të Autoritetit Qendror Bankar i Republikës së Kosovës.
2. Mandati i drejtorit menaxhues të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës zgjat pesë (5) vjet.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale